



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 82/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjez. Goran Milenković – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.P.N. "Dardania" - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull prokurimit: "Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje", me numër të prokurimit: 616-18-8990-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datën 19.03.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. HUDHET si e pa lejuar ankesa e operatorit ekonomik N.P.N. "Dardania" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje", me numër të prokurimit: 616-18-8990-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje", me numër të prokurimit: 616-18-8990-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.P.N. "Dardania" - Prishtinë, hudhet si e pa lejuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:23.11.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:12.12.2018

Njoftimi për anulimin e AP dt: 19.02.2019

Kërkesa për rishqyrtim me dt:20.02.2019.

Autoriteti Kontraktues me datën 21.02.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues N.P.N."Dardania" -Prishtinë,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me22.02.2019me nr. 82/19,kundër njoftimit për anulimin e AP-se, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje", me numër të prokurimit: 616-18-8990-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin1, 6, dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.02.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtuesprofesional tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuesnë raportin e dt:01.03.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit.

- Kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, parashtruesi i ankesës më datën 20.02.2019, ka paraqitur kërkesë për ri shqyrtim tek Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtinë, me pretendimet e njëjta ankimore të paraqitura si në ankesën e deponuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit.
- AK / Komuna Prishtinë, më datën. 21.02.2019, nxjerr vendim dhe refuzon të njëjtën kërkesë si të pa bazuar, me arsyetimin kryesor se AK, është mbështetur në vendimin e PSH.nr. 27/19, dhe ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Fillimisht po sqarojmë se kemi të bëjmë me ankesë të përsëritur dhe se Organi Shqyrtues i Prokurimit, përkatësisht Paneli Shqyrtues, përmes vendimit paraprak të datës 14.02.2019, me nr. 27/19, ka anuluar në tërësi këtë aktivitet të prokurimit, ku përmes arsyetimit të të njëjtit vendim përveç tjerash është konstatuar se, Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtinë, përmes dosjes së tenderit, paramasës dhe parallogarisë, tek njësia matëse ka aplikuar dy variante “orë pune dhe metër katror” si dhe “orë pune dhe metër kub”. Më tej potencohet se kontrata eventuale me njësi të tillë nuk mund të gjejë zbatim të mirëfilltë sepse nuk ka mundësi të bëhet pagesë reale përmes dy varianteve.

Edhe përmes raportit paraprak të ekspertizës i kemi trajtuar pretendimet ankimore, ku në mesin e tyre janë kontestuar edhe pozicione të caktuara të paramasës dhe parallogarisë, rrjedhimisht i kemi dhënë sqarimet dhe rekomandimet tona, pretendime të cilat janë gjykuar dhe vendosur përmes vendimit të lartpërmenduar, prandaj ri trajtimi i pretendimeve ankimore të gjykuara me vendim paraqet mos respektim të nenit 16 të rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, me nr. 01/2017.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE NPN “Dardani”- Prishtinë, të hedhet poshtë si e pa lejuat (konform nenit 16, i rregullores së punës së OSHP-s), dhe njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

Operatori ekonomik përmes parashtrësës me shkrim të datës: 07.03.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtrësës me shkrim të datës: 04.03.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, konstatimeve analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe shoshitjes së provave në tërësi në shqyrtim kryesor, konstaton se Autoriteti Kontraktues Komuna Prishtinë, i ka respektuar rekomandimet e dala përmes vendimitë datës 14.02.2019, me nr. 27/19, perkatesisht është konstatuar se Autoriteti Kontraktues, përmes dosjes së tenderit, tek njësia matëse ka aplikuar dy variante “orë pune dhe metër katror” si dhe “orë pune dhe metër kub”, rrjedhimisht me njësi të tillë është konstatuar se nuk mund të gjejë zbatim të mirëfilltë kontrata eventuale, sepse nuk ka mundësi të bëhet pagesë reale përmes dy varianteve.

Paneli shqyrtues sqaron se duke pas parasysh faktin se edhe përmes raportit paraprak të ekspertizës si dhe vendimin datës 14.02.2019, me nr. 27/19, kemi trajtuar pretendimet ankimore, ku në mesin e tyre janë kontestuar edhe pozicione të caktuara të paramasës dhe parallogarisë, rrjedhimisht i kemi dhënë sqarimet dhe rekomandimet tona, pretendime të cilat janë gjykuar dhe vendosur përmes vendimit të lartë përshkruar, prandaj ri trajtimi i pretendimeve ankimore të gjykuara me vendim paraqet mos respektim të nenit 16 të rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, me nr. 01/2017. Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Panelit shqyrtues konstaton se ankesa e OE NPN “Dardani”- Prishtinë, të hedhet poshtë si e pa lejuat (konform nenit 16, i rregullores së punës së OSHP-s), dhe njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna Prishtinë,–Prishtinë,
- 1x1 OE- N.P.N.“Dardania” – Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.


Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković